



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, 17.6.2019

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 17.6.2019, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me vendimin nr. 32, datë 5.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Brati

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

I nderuar trup gjykues,

Për sa i përket analizës financiare të vënë në dispozicion në seancën e datës 22.5.2019, jemi dakord me rezultatin e analizës, pasi në të gjejmë situatën faktike mbi mungesën e burimit të ligjshëm të të ardhurave për krijimin e pasurive, mbulimin e shpenzimeve të kryera nga subjekti si shlyerje borxhi, pagesa këstesh për kreditë, shpenzimet e jetesës, udhëtime, mobilime etj., sikundër dhe Komisioneri Publik ka mbajtur qëndrim në ankim¹.

Bazuar në analizën financiare të vënë në dispozicion dhe në shkaqet e ankimimit të Komisionerit Publik, konstatojmë se në rubrikën e të ardhurave:

- Shuma prej 3,100,000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë është konsideruar e ardhur e ligjshme në analizë, mbetet i pavërtetuar burimi i krijimit të të ardhurave² dhe ligjshmëria e tyre. Këto të ardhura kanë shërbyer si burim kryesor për krijimin e pasurisë së luajtshme, makinë e tipit “Mazda”, blerë në vitin 2011³.
- Shuma prej 492,495 lekë, “mundësi kursimi” në vitin 2014 (1,100,000 - 607,505), e konsideruar si e ardhur apo “Pakësim *cash* për shlyerje detyrimi”, në vitin 2015, është shumë hipotetike dhe jo reale për t’u konsideruar si e ardhur e mirëfilltë në analizë. Pasi “likuiditeti *cash*” është në nivel deklarativ dhe e pavërtetuar gjendja faktike e tij. Subjekti në këtë rast rezulton me pasaktësi në deklarim dhe pamundësi krijimi të shumës së deklaruar, në analizë nuk janë përfshirë shpenzime të tjera, të cilat mund të jenë kryer nga subjekti në këtë periudhë,

¹ Pika 16.4.4. e ankimit të Komisionerit Publik, i datës 14.8.2018.

² Referuar përgjigjes së DRT, Durrës, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë ***.4.2018, ku konstatohet se ish-bashkëshorti figuron i regjistruar në DRT Durrës, si person fizik, me NIPT ***, por nga verifikimi i dokumentacionit të arshvuar dhe të dhënave të sistemit elektronik, ky tatimpagues nuk ka asnjë deklaratë tatimore të dorëzuar për ushtrim të aktiviteti si avokat. Ky fakt pranohet nga ish-bashkëshorti, pasi në pyetësinë e Komisionit të datës ***.4.2018, ku deklaroi ndër të tjera se: “... shumën 1.000.000 lekë i kishte marrë hua tek disa shokë...”.

³ Në vitin 2011, subjekti deklaroi marrjen e shumës së konsiderueshme prej 1,000,000 lekësh në formë *cash*, si pension ushqimor, jo nëpërmjet sistemit bankar. Kjo shumë ndikon në rezultatin e analizës financiare të vitit, kur subjekti ka shlyer një pjesë të detyrimeve për pagesën e kësteve të blerjes së makinës e tipit “Mazda”, në shumën 1,069,074 lekë.

por që nuk e ka pasur detyrim ligjor për t'i deklaruar, pasi mund të kenë qenë nën shumën 300,000⁴ lekë.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mbartja e shumës së mbetur nga viti i mëparshëm ka kuptim në rastin e analizave financiare të bizneseve apo shoqërive tregtare që kryejnë veprimtari ekonomike fitimprurëse. Për ekonominë familjare apo individët subjekt deklarimi, siç janë subjektet e rivlerësimit, analiza bazohet në të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenin D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës, në shpenzimet e kryera dhe të deklaruara, si edhe kursimet *cash* të deklaruara. Pra, nuk ka kuptim që në rastin kur subjekti në vitin deklarues nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet *cash* të deklaruara dhe shpenzimet e kryera, të kryejmë rillogaritje dhe të përcaktojmë apriori shumën *cash* si “mundësi kursimi”.

- Për shumën 1,800,000 lekë, të dhuruara nga znj.***.***, jemi dakord me analizën e Kolegjit, pasi na rezulton pamundësia e krijimit të kësaj shume nga e ëma e subjektit edhe pas rillogaritjes me provat e sjella nga subjekti. Vërtetim ISSH, Dega e Arkivit, Lezhë nr. *** prot., datë ***.4.2019; Deklarate noteriale, nr. rep. *** kol. ***; datë ***.5.2019.

Ndërsa për sa i përket seksionit të shpenzimeve në analizën financiare të paraqitur, shprehemi dakord. Në analizë janë marrë në konsideratë deklaramet dhe e provat që subjekti i rivlerësimit ka dhënë gjatë hetimit administrativ.

Duke veçuar disa vite në këtë analizë financiare, konstatojmë se:

- Për vitin 2013*, diferenca negative është në shumën - **495,277 lekë** (katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë lekë), pra rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare dhe në mungesë të burimeve të ligjshme të kryente shpenzimet e deklaruara dhe të verifikuara në lekë.
- Për vitin 2014*, diferenca negative është në shumën - **607,505 lekë** (gjashtëqind e shtatë mijë e pesëqind e pesë lekë), pra rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare dhe në mungesë të burimeve të ligjshme të krijonte kursimin e dekluar *cash* në shumën 1.1 milionë lekë dhe të kryente shpenzimet përkatëse.
- Për vitin 2015*, diferenca negative rezulton në shumën - **1,444,602 lekë** (një milion e katërqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e dy lekë), vit ky i cili përkon me blerjen e pasurisë, apartament në Tiranë, si edhe deklarimi i kursimeve *cash* në shumën 1.1 milionë lekë. Pra, provohet se subjekti ka kryer deklaramet të pamjaftueshëm dhe se rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në kuptim kjo të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, konstatojmë se Kolegji ka marrë në konsideratë huan prej 25.000 euro.
- Për vitin 2016*, diferenca negative rezulton në shumën - **2,768,193 lekë** (dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre lekë). Në këtë vit, subjekti ka deklaruar se ka shlyer huan ndaj tezes së saj, në shumën 25,000 euro, burim për të cilin janë përdorur kursimet *cash* të deklaruara në vitet 2014 – 2015, si dhe shuma prej 1.8 milionë lekë, e deklaruar si e dhuruara nga nëna. Nga analiza financiare provohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në krijimin e kursimeve të deklaruara. I

⁴ Bazuar në rubrikën “shpenzime të deklarueshme”, të dhëna konfidenciale, të Deklaratës së interesave private/periodike/vjetore.

njëjti fakt rezulton edhe për “familjen Brati”, lidhur me mundësinë e kursimit të shumës së deklaruar si të dhuruar, në vlerën 1.8 milionë lekë.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga subjekti, në dokumentin: Kërkesë e paraqitur në seancën e datës ***.6.2019, paragrafi 7, që i referohet shkresës kthim përgjigje nr. ***, datë ***.1.2018, nga DRT Durrës, sqarohet:

Komisioneri Publik, referuar akteve të vëna në dispozicion nga KPK-ja, konstaton se: “shkresa nr. ***, datë ***.1.2018”, është shkresë e KPK-së, që i drejtohet DRT Durrës, me lëndë: “Kërkesë për informacion”, në përmbajtje kërkohet informacion për subjektin tregtar ***.*** me NIPT ***.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dhënat mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat si avokat, DRT Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2018, ka dërguar përgjigjen pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar xhiros së deklaruar për periudhën 1999 – 2002 (katër vite) në shumën totale 3,164,000⁵ lekë, sipas viteve përkatëse.

Ndërsa me shkresën e DTR Durrës, nr. *** prot., datë ***.1.2017, që i është dërguar subjektit të rivlerësimit, znj. A. Brati, referuar xhiros së realizuar për periudhën 1999 – 2003 (pesë vite) konfirmon në shumë totale 4,164,000⁶ lekë, sipas viteve përkatëse.

Për të qartësuar situatën dhe informacionin e ndryshëm, të dërguar nga DRT Durrës, Komisioneri Publik i kërkoi KPA-së hetim të mëtejshëm në lidhje me saktësinë e informacionit të DRT Durrës.

Pas kërkesës së KPA-së, informacioni i ardhur nga DRT Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë ***.12.2018, me lëndë “Saktësim të dhënash”, xhiroja e konfirmuar është në shumën 3,164,000⁷ lekë.

Pra, pretendimi i subjektit për xhiron e realizuar nga z. ***.***, në vitin 2003, nuk qëndron, pasi të dhënat janë saktësuar në përgjigjen që DRT Durrës ka dërguar në KPA.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA

⁵ Në vitin 1999 - xhiroja e deklaruar 200,000 lekë, në vitin 2000 - xhiroja e deklaruar 1,100,000 lekë, në vitin 2001 - xhiroja e deklaruar 1,220,000 lekë, në vitin 2002 - xhiroja e deklaruar 644,000 lekë.

⁶ Në vitin 1999 - xhiroja e deklaruar 200,000 lekë, në vitin 2000 - xhiroja e deklaruar 1,100,000 lekë, në vitin 2001 - xhiroja e deklaruar 1,000,000 lekë, në vitin 2002 - xhiroja e deklaruar 1,220,000 lekë, në vitin 2003 - xhiroja e deklaruar 644,000 lekë.

⁷ Në vitin 1999 - xhiroja e deklaruar 200,000 lekë, në vitin 2000 - xhiroja e deklaruar 1,100,000 lekë, në vitin 2001 - xhiroja e deklaruar 1,220,000 lekë, në vitin 2002 - xhiroja e deklaruar 644,000 lekë.